

Statistikat afatshkurtra

Tremujori II, 2014

Tiranë, më 30 Shtator: Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike publikojnë të dhënat e tremujorit të dytë 2014 sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 e cila zëvendëson Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev 1.1. Në mënyrë që të reflektohen ndryshimet e ndodhura në strukturën e ekonomisë, të gjithë treguesit në këtë tremujor paraqiten me bazë të përditësuar, nga 2005 në 2010. Anketa mbulon në mënyrë të përmblodhur tri aktivitete kryesore: Industri, Ndërtim, dhe Shërbime (përfshi aktivitetin “Tregti”). *(Shih shënime metodologjike, fq.17).*

Indeksi i volumit të shifrës së afarizmit, vlerësuar me çmime fikse (2010=100) arriti 115,7 % në tremujorin e dytë 2014.

Ndryshimi vjetor i indeksit të volumit të shifrës së afarizmit pasqyron rritje prej 2,8 % në aktivitetet ekonomike, krahasuar me tremujorin e dytë 2013. Ky ndryshim në të njëjtin tremujor të vitit 2013 ishte 5,3 %. Në këtë rritje ndikojnë aktivitetet që kryhen në sektorët “Industri” dhe “Shërbime”, me 8,5 % dhe 7,4 %.

Në aktivitetin “Industri”, kontributin kryesor në shifrën e afarizmit në volum, e jep Industria Nxjerrëse me 20,4 %. Ky tregues në aktivitetet “ Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë” paraqitet me rritje 9,8 %, ndërsa “Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar” paraqitet me rënie 9,7 %. Aktiviteti i ndërtimit në këtë tremujor pasqyron rënie të këtij treguesi me 15,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Në rritjen prej 7,4 % të shifrës së afarizmit në volum, në “Shërbime”, në tremujorin e dytë 2014 krahasuar me tremujorin e dytë 2013, kanë ndikuar kryesisht aktivitetet: “Agjenci e udhëtimit” me 37,0 %, “Informacioni dhe Komunikacioni” me 25,1 %, “Hotele” me 20,5 %, dhe “Tregti” me rritje prej 7,2 %.

Ndryshimi tremujor i treguesit të shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e dytë 2014, paraqitet me rritje prej 12,8 %, krahasuar me tremujorin e parë 2014. Rritja vjen kryesisht nga aktivitetet: “Ndërtim” me 20,5 %, “Industri nxjerrëse” me 16,6 %, “Industri Përpunuese” me 16,3 %.

Në krahasim me tremujorin e parë 2014, në aktivitetet e Shërbimeve, shifra e afarizmit në volum, pasqyron rritje me 13,3 % si rezultat i rritjes së degëve: “Hotele” 45,6 %, “Agjenci Udhëtimi” 19,7 % dhe “Tregti me shumicë” me 14,8 %, etj.

“Numri i të punësuarve me pagesë” dhe “Fondi i pagave” në ndërmarrje pasqyrojnë rritje në tremujorin e dytë 2014 në krahasim me tremujorin e dytë 2013, me 17,6 % dhe 14,8 %. Ndërsa, ndryshimi tremujor i këtyre treguesve, Tr II – 2014 / Tr I – 2014, është 3,3 % dhe 4,4 %.

Fig. 1 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum në Industri, Ndërtim dhe Shërbime



Tab. 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum, sipas aktivitetit ekonomik

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	II - 13 II - 12	III - 13 III - 12	IV - 13 IV - 12	I - 14 I - 13	II - 14 II - 13
	Aktivitetet ekonomike gjithsej	5,3	-2,0	4,7	2,3	2,8
B+C	Industri	2,3	-1,9	11,3	4,2	8,5
B	Industri Nxjerrëse	41,6	33,5	68,2	20,5	20,4
C	Industri Përpunuese	-6,4	-9,7	-1,5	0,2	5,6
D	Prodhim dhe Shpërndarje energji, avull	41,4	14,8	14,0	-3,2	-9,7
E	Prodhim dhe furnizim me ujë	31,9	38,2	40,0	-2,6	9,8
F	Ndërtim	6,0	-16,3	-9,3	-2,7	-15,6
G - N	Shërbime	1,8	-0,7	4,8	4,3	7,4
G	Tregti	2,0	-1,0	5,8	5,4	7,2
H (49-53)	Transport dhe magazinim	16,8	18,9	-22,7	-36,2	-27,4
I (551)	Hotele dhe struktura të ngjashme	-3,7	-14,3	-22,0	-5,8	20,5
J (58-62)	Informacioni dhe komunikimi	-13,5	-15,9	4,5	9,9	25,1
M (71)	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	29,6	70,0	59,8	57,7	47,6
N (79)	Agjenci udhëtimi, operator turistik	-18,8	3,3	41,4	30,6	37,0

Tab. 2 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum, sipas aktivitetit ekonomik

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	II - 13 I - 13	III - 13 II - 13	IV - 13 III - 13	I - 14 IV - 13	II - 14 I - 14
	Aktivitetet ekonomike gjithsej	12,2	4,0	7,7	-18,6	12,8
B+C	Industri	11,8	2,7	6,2	-14,6	16,4
B	Industri nxjerrëse	16,7	1,0	22,9	-16,8	16,6
C	Industri përpunuese	10,3	3,3	1,0	-12,9	16,3
D	Energjia	-6,1	-17,3	10,2	13,1	-12,4
E	Prodhim dhe furnizim me ujë	-3,7	12,9	1,5	-11,7	8,5
F	Ndërtim	39,0	-20,4	21,4	-27,6	20,5
G - N	Shërbime	10,1	13,8	5,4	-21,0	13,3
G	Tregti	12,2	12,4	6,1	-21,2	14,1
H (49-53)	Transport	10,3	23,6	-40,2	-21,8	25,4
I (551)	Hotele dhe struktura të ngjashme	13,9	8,0	-7,2	-17,5	45,6
J (58-62)	Informacion dhe komunikim	-9,6	22,2	34,1	-25,8	2,9
M (71)	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	11,2	10,2	6,4	21,0	4,0
N (79)	Agjenci udhëtimi, operator turistik	14,1	17,8	14,2	-14,9	19,7

Industria

Në tremujorin e dytë 2014, shifra e afarizmit në volum në "Industri" (përfshi Industri Nxjerrëse dhe Përpunuese), është rritur 8,5 % krahasuar me tremujorin e dytë 2013. Në këtë rritje ndikon aktiviteti "Industri Nxjerrëse" me 20,4 %. Referuar të njëjtës periudhë krahasimore, aktiviteti "Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë" paraqitet me rritje 9,8 %, ndërsa aktiviteti "Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar" me rënie 9,7 %.

Volumi i prodhimit industrial shënoi një rritje prej 4,3 % në tremujorin e dytë 2014, ndërsa volumi i prodhimit të Energjisë elektrike shënoi një rënie me 38,0 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2013.

Numri i të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet e aktivitetit "Industri" (Industri Nxjerrëse dhe Përpunuese) u rrit me 21,0 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2013, ndryshim i cili vjen kryesisht nga rritja e këtij treguesi në "Industri Përpunuese". Për aktivitetet "Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar" dhe "Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë", ky tregues paraqitet me rritje 8,8 % dhe 6,1 %. Niveli i fondit të pagave shënoi një rritje prej 18,5 % në "Industri", 24,3 % në "Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar" dhe 8,7 % në "Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë".

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në Industri, paraqitet me rritje 16,4 %. Të dy degët përbërëse si "Industri Nxjerrëse" dhe "Përpunuese" kanë patur rritje me 16,6 % dhe 16,3 %. Aktiviteti "Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë" shënoi rritje në 8,5 %, ndërsa aktiviteti "Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar" shënoi rënie me 12,4 %.

Gjatë tremujorit të dytë 2014, volumi i prodhimit industrial shënoi një rënie me 4,6 % krahasuar me tremujorin paraardhës, Tr I – 2014, ndërsa volumi i prodhimit të energjisë u rrit me 8,7 % referuar të njëjtës periudhë krahasimore.

Me një rritje prej 2,8 % rezulton numri i të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet e aktivitetit "Industri", rritje e cila vjen kryesisht nga ndikimi i Industrisë Përpunuese. Ky tregues paraqitet me një rritje prej 0,6 % në Energjinë elektrike, gazin dhe avullin dhe rritje prej 1,0 % në aktivitetin e Grumbullimit dhe furnizimit me ujë. Fondi i pagave shënoi rritje në aktivitetet "Industri", "Energji elektrike" dhe "Grumbullimi dhe furnizimi me ujë", me 5,9 %, 6,1 % dhe 9,3 %.

Fig.2 Indeksi i shifrës së afarizmit dhe prodhimit industrial në Industri Nxjerrëse dhe Përpunuese




Fig.3 Indeksi i shifrës së afarizmit në Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese, Energji Elektrike dhe Grumbullimi dhe furnizimi me ujë





Fig. 4 Sasia e prodhimit të Energjisë Elektrike

000/kw-orë



Tab. 3 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Industri

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
			II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13
B-C	05-33	Industri	2,3	-1,9	11,3	4,2	8,5
B	05-09	Industri Nxjerrëse	41,6	33,5	68,2	20,5	20,4
C	10-33	Industri Përpunuese	-6,4	-9,7	-1,5	0,2	5,6
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	41,4	14,8	14,0	-3,2	-9,7
E	36-39	Grumbullimi dhe furnizimi me ujë	31,9	38,2	40,0	-2,6	9,8

Tab. 4 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Industri

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
			I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
B-C	05-33	Industri	11,8	2,7	6,2	-14,6	16,4
B	05-09	Industri Nxjerrëse	16,7	1,0	22,9	-16,8	16,6
C	10-33	Industri Përpunuese	10,3	3,3	1,0	-12,9	16,3
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	-6,1	-17,3	10,2	13,1	-12,4
E	36-39	Grumbullimi dh e furnizimi me ujë	-3,7	12,9	1,5	-11,7	8,5

Tab. 5 Ndryshimi vjetor i Indeksit të volumit të prodhimit industrial

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
			II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13
B-C	05-33	Industri	19,3	13,7	25,3	21,3	4,3
B	05-09	Industri Nxjerrëse	45,8	34,4	56,9	20,4	0,9
C	10-33	Industri Përpunuese	-1,5	-2,7	-0,6	20,0	6,1
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	122,6	35,0	87,8	-18,0	-38,0
E	36-39	Grumbullimi dhe furnizimi me ujë	-2,4	28,6	-8,9	-7,9	-0,4

Tab. 6 Ndryshimi tremujor i Indeksit të volumit të prodhimit industrial

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
			I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
B-C	05-33	Industri	10,9	2,4	2,8	3,9	-4,6
B	05-09	Industri Nxjerrëse	13,7	2,8	12,9	-8,8	-4,6
C	10-33	Industri Përpunuese	8,0	1,9	-8,5	19,2	-4,5
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	43,8	-63,4	35,7	14,7	8,7
E	36-39	Grumbullimi dhe furnizimi me ujë	2,2	36,2	-25,7	-11,0	10,5

Tab. 7 Ndryshimi vjetor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Industri

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
			II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13
B-C	05-33	Industri	5,7	9,9	10,3	15,7	21,0
B	05-09	Industri Nxjerrëse	25,0	22,9	18,4	4,0	-0,3
C	10-33	Industri Përpunuese	2,5	7,7	8,9	17,5	24,9
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	5,8	8,2	12,0	10,6	8,8
E	36-39	Grumbullimi dhe furnizimi me ujë	7,9	11,2	14,8	3,2	6,1

Tab. 8 Ndryshimi tremujor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Industri

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
			I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
B-C	05-33	Industri	-1,8	0,9	3,0	13,3	2,8
B	05-09	Industri Nxjerrëse	3,9	-1,3	-2,3	3,8	-0,4
C	10-33	Industri Përpunuese	-2,8	1,3	4,0	14,7	3,2
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	2,3	1,1	-0,9	7,9	0,6
E	36-39	Grumbullimi dhe furnizimi me ujë	-1,8	3,4	1,0	0,6	1,0

Tab. 9 Ndryshimi vjetor i Indeksit të fondit të pagave në Industri

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
			II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13
B-C	05-33	Industri	20,8	25,0	21,7	13,5	18,5
B	05-09	Industri Nxjerrëse	53,1	54,2	41,3	-0,1	6,3
C	10-33	Industri Përpunuese	7,3	12,2	13,1	18,7	24,0
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	20,0	27,8	14,5	23,8	24,3
E	36-39	Grumbullimi dhe furnizimi me ujë	21,0	10,4	33,0	-2,5	8,7

Tab. 10 Ndryshimi tremujor i Indeksit të fondit të pagave në Industri

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
			I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
B-C	05-33	Industri	1,4	4,2	1,4	6,0	5,9
B	05-09	Industri Nxjerrëse	4,8	6,8	-4,2	-6,8	11,4
C	10-33	Industri Përpunuese	-0,5	2,6	4,8	10,9	4,0
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	5,7	6,7	1,6	8,1	6,1
E	36-39	Grumbullimi dhe furnizimi me ujë	-1,9	-8,2	16,5	-7,0	9,3


Ndërtimi

Në aktivitetin e Ndërtimit, shifra e afarizmit në volum, në tremujorin e dytë 2014 shënoi një rënie prej 15,6 % krahasuar me tremujorin e dytë 2013. Volumi i ndërtimit paraqitet me një rënie prej 10,3 %.

Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet e Ndërtimit në tremujorin e dytë 2014 paraqitet me një rritje prej 16,7 % krahasuar me tremujorin e dytë 2013, ndërsa fondi i pagave shënoi një rritje prej 10,8 % gjatë së njëjtës periudhë.

Në tremujorin e dytë 2014, shifra e afarizmit në volum, shënoi një rritje prej 20,5 % krahasuar me tremujorin e parë 2014, ndërsa volumi i ndërtimit është rritur me 31,7 % gjatë së njëjtës periudhë.

Fig. 5 Indekset e shifrës së afarizimit dhe volumit të ndërtimit



Tab. 11 Ndryshimi vjetor i Indekseve të treguesve në Ndërtim

(2010=100)

(%)

NVE Rev.2	Treguesit	II 2013	III 2013	IV 2013	I 2014	II 2014
		II 2012	III 2012	IV 2012	I 2013	II 2013
41-43	Shifra e afarizmit	6,0	-16,3	-9,3	-2,7	-15,6
	Volumi i ndërtimit	5,5	-15,8	-10,1	-1,2	-10,3
	Të punësuar me pagesë	-11,2	-5,8	2,0	8,3	16,7
	Fondi i pagave	0,7	15,4	20,5	0,8	10,8

Tab. 12 Ndryshimi tremujor i Indekseve të treguesve në Ndërtim

(2010=100)


(%)

NVE Rev.2	Treguesit	II 2013	III 2013	IV 2013	I 2014	II 2014
		I 2013	II 2013	III 2013	IV 2013	I 2014
41-43	Shifra e afarizmit	39,0	-20,4	21,4	-27,6	20,5
	Volumi i ndërtimit	45,0	-18,2	16,0	-28,2	31,7
	Të punësuar me pagesë	-5,9	0,4	0,2	14,3	1,4
	Fondi i pagave	-7,4	9,2	-4,3	4,2	1,7

Fig. 6 Indeksi i volumit të ndërtimit në Ndërtime të reja, Rikonstruksione dhe Punime inxhinierike

(2010=100)

(%)



Shërbime

Në tremujorin e dytë 2014, shifra e afarizmit në volum, në fushën e Shërbimeve është rritur 7,4 % krahasuar me tremujorin e dytë 2013. Në këtë rritje ndikojnë aktivitetet: “Agjenci udhëtimi”, me 37,0 %, “Hotele”, 20,5 %, dhe “Informacioni dhe Komunikacioni” me 25,1 %. Në aktivitetet “Transport dhe Magazinim, ku përfshihet dhe aktiviteti Postar”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e dytë 2014 krahasuar me tremujorin e dytë 2013, paraqitet me rënie prej 25,9 %.

Në tremujorin e dytë 2014, në ndërmarrjet e aktivitetit të Shërbimeve ka pasur një rritje të numrit të të punësuarve me pagesë me 16,5 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa krahasuar me tremujorin e parë 2014, ky tregues paraqet rritje me 5,6 %.

Në fushën e Shërbimeve, në tremujorin e dytë 2014, ka patur një rritje të fondit të pagave me 12,2 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa krahasuar me tremujorin e parë 2014 fondi i pagave paraqitet me rritje 3,6 %.

Tregti me shumicë dhe pakicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe Tregtia me shumicë

Shifra e afarizmit në volum, në aktivitetin “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve”, në tremujorin e dytë 2014 krahasuar me tremujorin e dytë 2013, është rritur me 14,0 %, dhe aktiviteti “Tregti me shumicë” është rritur me 5,9 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetet: “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve” dhe “Tregti me shumicë” paraqet rritje prej 19,8 % dhe 14,8 %, në tremujorin e dytë 2014 në krahasim me tremujorin parë 2014.

Në tremujorin e dytë 2014, në ndërmarrjet e aktivitetit të “Tregtisë me shumicë” ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë është rritur 12,6 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2013. Ndërsa krahasuar me tremujorin e parë 2014, ky tregues paraqet rritje 1,0 %.

Në aktivitetin e “Tregtisë me shumicë”, në tremujorin e dytë 2014, ka patur një rritje të fondit të pagave me 14,4 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa krahasuar me tremujorin e parë 2014 fondi i pagave paraqitet me 5,1 % rritje.

Transporti dhe Magazinimi (përfshirë dhe aktiviteti Postar)

Në aktivitetet “Transporti dhe Magazinimi”, ku përfshihet dhe aktiviteti Postar, shifra e afarizmit në volum, ka pësuar rënie me 27,4 %, në tremujorin e dytë 2014 krahasuar me tremujorin e dytë 2013, si rezultat i ndikimit negativ të Transportit Ajror. Ky tregues paraqitet me rritje të ndjeshme në Transportin Hekurudhor dhe në Transportin Ujor. Gjithashtu, me rritje 11,0 % është ndryshimi i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetet e Postës, krahasuar me tremujorin e dytë 2013.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet e transportit dhe magazinimit paraqet rënie 5,7 % krahasuar me tremujorin e dytë 2013. Rënie paraqet edhe ndryshimi vjetor i indeksit të fondit të pagave me 4,9 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetet “Transport dhe Magazinim”, përfshirë dhe aktivitetin postar, është rritur 25,4 %, ku kryesisht ka ndikuar rritja e këtij treguesi në aktivitetin e Transportit Hekurudhor. Në aktivitetin Postar, indeksi i shifrës së afarizmit në volum krahasuar me tremujorin e parë 2014 paraqet rritje 3,9 %.

Ndërsa, indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet e transportit dhe magazinimit paraqet rënie 1,4 %. Indeksi i fondit të pagave krahasuar me tremujorin e parë 2014 është rritur 6,3 %.

Hotelet

Në seksionin “Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor”, në Hotele, shifra e afarizmit në volum, rritet 20,5 % në tremujorin e dytë 2014 krahasuar me tremujorin e dytë 2013. Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë dhe fondi pagave në ndërmarrjet e aktivitetit “Hotele” paraqet rritje 24,2 % dhe 22,5 % krahasuar me tremujorin e dytë 2013.

Në tremujorin e dytë 2014, aktivitetin “Hotele”, krahasuar me tremujorin e parë 2014, shifra e afarizmit në volum paraqet rritje të ndjeshme 45,6 %. Ndryshimi tremujor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë dhe i fondit të pagave në po të njëjtin aktivitet paraqitet me rritje 8,0 % dhe 9,7 %.

Informacioni dhe Komunikacioni

Seksioni “Informacioni dhe Komunikacioni”, në aktivitetet e komunikacionit, shërbimet informatike si dhe botimin e librave, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, është rritur 25,1 % në tremujorin e dytë 2014 krahasuar me tremujorin e dytë 2013. Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë dhe fondi i pagave në ndërmarrjet e aktivitetit “Informacioni dhe Komunikacioni” paraqet rritje 13,3 % dhe 17,9 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në aktivitetet “Informacioni dhe Komunikacioni”, paraqitet me rritje 2,9 % krahasuar me tremujorin paraardhës. Ndryshimi tremujor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet e aktivitetit “Informacioni dhe Komunikacioni” paraqet rritje 5,0 %, ndërsa ndryshimi tremujor i indeksit të fondit të pagave paraqet rënie 6,4 %.

Aktivite të Arkitekturës dhe Inxhinierike

Shifra e afarizmit në volum në “Aktivite Profesionale, Shkencore dhe Teknike”, ndonëse me një peshë të vogël në aktivitetin e shërbimeve, rritet 47,6 % në tremujorin e dytë 2014 krahasuar me tremujorin e dytë 2013. Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë dhe i fondit të pagave në ndërmarrjet e “Aktivite të Arkitekturës dhe Inxhinierike” paraqesin rritje 38,4 % dhe 21,1 % krahasuar me tremujorin e dytë 2013.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, paraqet rritje me 4,0 %, krahasuar me tremujorin paraardhës. Në ndërmarrjet e këtij aktiviteti me rritje paraqiten edhe indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë dhe i fondit të pagave 5,6 % secila.

Agjencitë e udhëtimit

Në seksionin “Shërbime administrative dhe mbështetëse”, në aktivitetin e Agjencive të Udhëtimit, shifra e afarizmit në volum, rritet 37,0 % në tremujorin e dytë 2014 krahasuar me tremujorin e dytë 2013. Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet e aktivitetit “Agjenci udhëtimi” paraqet rritje 2,7 %, ndërsa indeksi i fondit të pagave paraqitet me rënie 6,7 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, paraqet rritje 19,7 % krahasuar me tremujorin paraardhës. Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në këtë aktivitet paraqet rënie 3,5 %, ndërsa indeksi i fondit të pagave paraqitet me rritje 3,4 %.

Tab. 13 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Shërbime

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
		II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	4,3	1,1	-3,1	-2,2	14,0
G(46)	Tregtia me shumicë	1,1	-0,8	7,2	5,3	5,9
H(49-53)	Transport dhe Magazinim	16,8	18,9	-22,7	-36,2	-27,4
I(5500)	Hotele	-3,7	-14,3	-22,0	-5,9	20,5
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe Komunikacioni	-13,5	-15,9	4,5	9,9	25,1
M(71)	Aktivite të Arkitekturës dhe Inxhinierike	29,6	70,0	59,8	57,69	47,6
N(79)	Agjenci Udhëtimi	-18,7	3,3	41,4	30,7	37,0

Tab. 14 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Shërbime

(2010=100)


(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
		I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	2,8	0,6	-2,5	-3,1	19,8
G(46)	Tregtia me shumicë	14,2	14,6	6,5	-24,4	14,8
H(49-53)	Transport dhe Magazinim	10,3	23,6	-40,2	-21,8	25,4
I(5500)	Hotele	13,9	8,0	-7,2	-17,5	45,6
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe Komunikacioni	-9,6	22,2	34,1	-25,8	2,9
M(71)	Aktivite të Arkitekturës dhe Inxhinierike	11,2	10,2	6,4	21,0	4,0
N(79)	Agjenci Udhëtimi	14,1	17,8	14,2	-14,9	19,7

Fig. 7 Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë dhe fondi i pagave, në Shërbime

(2010=100)

(%)



Tab. 15 Ndryshimi vjetor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Shërbime

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
		II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	6,7	4,6	6,1	9,8	17,4
G(46)	Tregtia me shumicë	11,1	10,7	11,6	9,5	12,6
H(49-53)	Transport dhe Magazinim	3,5	2,1	-4,4	-4,6	-5,7
I(5500)	Hotele	6,7	0,4	4,5	8,9	24,2
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe Komunikacioni	-20,9	-26,5	-19,8	-13,5	13,3
M(71)	Aktivtete të Arkitekturës dhe Inxhinierike	49,2	49,7	82,1	22,7	38,4
N(79)	Agjenci Udhëtimi	7,0	18,4	30,3	0,7	2,7

Tab. 16 Ndryshimi tremujor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Shërbime

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV -13	I - 14	II - 14
		I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	2,8	-0,3	0,9	6,2	9,9
G(46)	Tregtia me shumicë	-1,7	-0,2	2,4	9,1	1,0
H(49-53)	Transport dhe Magazinim	-0,3	-0,3	-7,1	3,3	-1,4
I(5500)	Hotele	-5,3	11,1	-9,9	14,9	8,0
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe Komunikacioni	-19,9	-6,1	9,7	4,7	4,8
M(71)	Aktivite të Arkitekturës dhe Inxhinierike	-6,4	2,0	27,9	0,4	5,6
N(79)	Agjenci Udhëtimi	-5,3	6,3	-1,7	1,9	-3,5

Tab. 17 Ndryshimi vjetor i Indeksit të fondit të pagave në Shërbime

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
		II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13	II - 13
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	10,4	7,6	13,5	5,3	7,9
G(46)	Tregtia me shumicë	19,6	15,6	14,6	4,0	14,4
H(49-53)	Transport dhe Magazinim	3,4	14,4	-11,6	-14,8	-4,9
I(5500)	Hotele	8,8	8,4	10,7	9,1	22,5
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe Komunikacioni	-8,3	-21,5	0,5	12,1	17,9
M(71)	Aktivite të Arkitekturës dhe Inxhinierike	25,6	33,1	71,1	1,2	21,1
N(79)	Agjenci Udhëtimi	37,5	39,2	53,4	-11,3	-6,7

Tab. 18 Ndryshimi tremujor i Indeksit të fondit të pagave në Shërbime

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 13	III - 13	IV -13	I - 14	II - 14
		I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	3,5	1,8	3,7	-3,7	6,1
G(46)	Tregtia me shumicë	-4,5	-2,0	0,7	10,4	5,1
H(49-53)	Transport dhe Magazinim	-4,8	6,7	-18,4	2,8	6,3
I(5500)	Hotele	-2,3	9,2	-7,6	10,7	9,7
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe Komunikacioni	-11,0	-10,8	28,6	9,8	-6,4
M(71)	Aktivite të Arkitekturës dhe Inxhinierike	-11,8	1,0	30,7	-13,1	5,6
N(79)	Agjenci Udhëtimi	-1,6	1,9	3,5	-14,5	3,4

Metodologjia

Informacion

INSTAT si rrjedhojë e detyrimeve që ka ndaj Eurostat, për përshtatshmëri të plotë të statistikave shqiptare me ato të vendeve Europiane, po publikon Indekset e aktiviteteve Industri, Ndërtim, Tregti (përfshirë Tregti me Pakicë) dhe Shërbime, me disa ndryshime metodologjike, të cilat i referohen:

- Aplikimi i Nomenklaturës së rishikuar të aktiviteteve ekonomike, NVE Rev.2;
- Ri-peshimi, përditësohen peshat e përfaqësimit, nga 2005 në 2010
- Ri-referimi, përditësohet periudha referuese nga 2005=100 në 2010=100;

Aplikimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2, bëhet me akt ligjor të miratuar me VKM Nr 320 datë 28.05.2014.

Për më shumë shikoni linkun: http://www.instat.gov.al/media/248316/njoftim_per_media_-_ndryshimi_i_nomenklatur_s_s_veprimtarive_ekonomike_rev_2.pdf

Klasifikimi i rishikuar është në mënyrë të konsiderueshme i ndryshëm nga klasifikimi ekzistues në drejtim të strukturës, klasifikimit dhe trajtimit metodologjik të disa aktiviteteve.

Kalimi i njësive statistikore nga NVE Rev.1.1 në NVE Rev.2 është bërë nëpërmjet ndërtimit të matricës së konvertuar, bazuar në informacionin statistikor të përfutur nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, 2010.

Referuar pikërisht kësaj matrice, disa nga grup-aktivitetet që janë publikuar me NVE Rev.1.1 përgjithësisht kalojnë 100 përqind në grup aktivitete publikimi në NVE Rev.2. Ndryshimet që kryesisht sjellë klasifikimi i ri për aktivitetet përbërëse të fushës së mbulimit të ATN, janë si më poshtë:

- a. Sipas klasifikimit të vjetër (NVE Rev. 1) aktivitetet e "Publikimit" përkojnë me ndarjen 22. Në klasifikimin e ri (NVE Rev. 2) "Aktivitete publikimi" përkon me ndarjen 58, seksioni J, "Informacioni dhe Komunikacioni".
- b. Ndarja 45, që përkon me NVE Rev.1.1 në aktivitetin e "Ndërtimit", detajohet në tre ndarje në klasifikimin e ri, në 41, "Ndërtimi i ndërtesave", 42, "Punime inxhinierike" dhe 43 "Punime të specializuara ndërtimi". Pjesë e ndarjes 41 bëhet edhe grupi 70.1 që përkon në NVE Rev.1.1, me aktivitetin "Aktivitete mbi pasuritë e patundshme".

- c. Aktivitetet e postave dhe korrierës, që përkon në NVE Rev. 1.1, me klasat 64.11 dhe 64.12, kalon në aktivitetin “Transport dhe magazinim”, që përkon në NVE Rev.2 me ndarjen 58, “Aktiviteti i postës dhe korrierës”.
- d. Një tjetër risi e klasifikimit të ri, me ndikim në publikimin e indeksit të statistikave afatshkurtra (tremujore) është edhe ardhja në fushën e mbulimit të aktiviteteve si: “Grumbullimi dhe Trajtimi i mbeturinave”, që përkon me klasifikimin NVE Rev.1.1, ndarja 90. Në klasifikimin e ri, NVE Rev.2, këto aktivitete i përkojnë ndarjes 38, “Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve”. Bëhet pjesë e kësaj ndarje edhe grupi 38.3, që përkon në NVE Rev.1.1, me ndarjen 37, “Riciklimi”.
- e. Në grupin 71.00, që përkon në NVE Rev.2, me “Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike, aktivitete të kontroleve dhe analizave teknike”, përfshihen edhe aktivitete të veçanta të grupeve 74.3 -74.8, që përkon me NVE Rev.1.1 me “Aktivitete të kontrollit dhe analiza teknike”.

Treguesi kryesor i shifrës së afarizmit është përdorur për rivlerësimin e kalimit të aktiviteteve ekonomike nga nomenkatura e vjetër në nomenklaturën e re. Metodatat kryesore të përdorura për vlerësim janë dy:

- Metoda e vlerësimit në nivel mikro
- Metoda e vlerësimit në nivel makro

Metoda e parë, u përdor për tre vitet e para të riklasifikimit të aktiviteteve të njësive në nivel individual në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve, 2010-2012;

Metoda e dytë, u përdor për rivlerësimin e të dhënave në seri kohore pas, për periudhën 2005-2010.

Ri-peshimi – për reflektuar ndryshimet e strukturës së ekonomisë, peshat përditësohen, sipas metodologjisë së statistikave europiane sipas aktiviteteve përfaqësuese, nga 2005 në 2010.

Ri –referim - shprehimisht do të thotë kalimi i indekseve me një periudhë referuese të re, nga 2005=100 në 2010=100. Seritë e të dhënave, të llogaritura me të dy periudhat, janë ekuivalente me njëra-tjetrën: ritmet e rritjes janë të njëjta, dhe një seri mund të konvertohet tek tjetra.

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike (35)
- Grumbullim, trajtim dhe furnizim me ujë (36)
- Ndërtim (41, 42, 43)

Shërbime, të cilat përbëhen nga Tregtia me shumicë, Hotele, Transport dhe Magazinim, Agjenci udhëtimi, Komunikacion dhe Informacion dhe shërbime të tjera:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor, përfshi vetëm Hotele (55.1)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku:

Kampioni për ndërmarrjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2010=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për aktivitetin hotelier, si dhe Shitjen dhe riparimin e automjeteve. Për aktivitetet e

transportit përdoret deflator i llogaritur në mënyrë implicite nga të dhënat administrative. Indekset nuk janë të vlerësuara sezonalisht.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shifra e afarizmit - Shifra e afarizmit përfshin shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i Shifrës së afarizmit - Objektivi i indeksit të shifrës së afarizmit është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

Numri i të punësuarve me pagesë - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përfshirë të vetëpunësuarit me pagesë).

Indeksi i Numrit të punësuarve me pagesë - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuar.

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuara në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.